

SHABAN SINANI

## NAIMI DHE RUMIU, NË KONTEKSTIN E PRANISË KULTURORE PERSO-IRANIANE NË TRADITËN SHQIPTARE

### I. Naim Frashëri në dy letërsi dhe në dy histori letërsie të tyre

Megjithëse gjatë shekullit XX e më pas historia e letërsisë shqipe është shkruar e rishkruar disa herë, nga studiues vendës e të huaj, nga individë e institucione, vlerësimi për Naim Frashërin ka mbetur gjithnjë i pandryshuar. Ai është cilësuar në njëjës *poeti kombëtar*, *Dichter misionar*, *poeti-profet*, me një *rol mesianik* në themelimin e identitetit dhe të gjuhës së shkruar shqipe. *Si Naimi s'ka të tjerë*, shkroi Andon Zako Çajupi, një poet i njohur bashkëkohës i Naimit në ditën e vdekjes së tij, dhe ky mendim nuk ka ndryshuar. *101 poetë për Naimin* është titulli i njëres prej antologjive me poezi të zgjedhura kushtuar atij përgjatë një shekulli. Me emrin e tij studiuesit lidhin shfaqjen për herë të parë të *dukurisë së prometeizmit* në historinë e letërsisë kombëtare (Qosja 1988 : 396).

Naim Frashëri është konsideruar *klasik e ustà* nga të huaj e shqiptarë (Geraci 2014 : 40; Agolli : 1980), madje edhe *babazot* i letërsisë dhe gjuhës shqipe të njësuar. Ai ka bashkuar fort mendimtarët që i kanë dhënë kuptim jetës së tyre me *mitin e Perëndimit* (Maloki 1937) dhe ata që, në të kundërtën, i kanë besuar thënies së njohur të shekujve të humanizmit evropian: *Ex Orientae lux - Dritë që vjen prej Lindjes*. Mihal Grameno, luftëtar e poet i fundit të Rilindjes, e quante Naimin *zemra e Shqipërisë*, kurse Frashërin, vendlindjen e tij, e krahasonte me *Mekën* dhe *Betlehemin*: *Si ty, o Vithehem e Mek' e Arabisë / Ku janë lindur Muhamet e Krishti i Krishterisë / Për mua është Frashëri, vënd i Perëndisë / Tek është lindur Naim Beu zemr' e Shqipërisë*<sup>1</sup>. Ndërsa Àt Gjergj Fishta, poet dhe mendimtar, figura më e rëndësishme e klerit katolik në gjysmën e parë të shekullit XX, i fundmi i romantizmit shqiptar, në kryeveprën e tij *Lahuta e Malcís* shkruan: *Bini toskë, ju n'pikë të vrapit / Mos t'u ndalin mal as zall / Naim Frashëri i rà qitapit / Mos m'e lshue Shqypnin per t'gjall*<sup>2</sup>. (Fishta 1937 : 468-473). Ndërsa për Abdyl Frashërin dhe rolin e tij si prijës i

<sup>1</sup> *Si ti, o Betlehem, o Mekë e Arabisë / Ku janë lindur Muhamet' e Krishti i krishterisë / Për mua është Frashëri - vënd i Perëndisë / Tek është lindur Naim beu, zemër e Shqipërisë.*

<sup>2</sup> *Bini toskë, ju n'pikë të vrapit, / Mos t'ju ndalë as mal, as zall, / Naim Frashëri shkroi në qitap, / Mos me e lëshue Shqipninë për t'gjallë.*

lëvizjes për pavarësi do të shkruante: *Aj âsht trimi Frasher begu / Qi gjithkund ke e qiti shtegu / I la naâm aj Toskënîs / Faqe t'bardhë i la Shqypnîs* (Fishta 1937 : 182-185).

Megjithëse pasardhës i vjershëtorëve të njohur bejtexhinj e bektashinj Dalip e Shahin Frashëri: i pari autor i poemës së përshtatur nga *Hadikaja* e Fuzuliut, që e titulloi shqip *Kopshti i të mirëve*, kushtuar *epopesë së Qerbelasë*; kurse i dyti autor i poemës heroike *Mühtarname* (*Poema e lavdisë së Mühtarit*), lidhja e tij farefisnore me ta thuhet nuk u përmend ndonjëherë. Për më tepër, megjithëse edhe vetë Naimi shkroi një poemë për Qerbelanë, duke ndjekur udhën e Frashërlliu të mëhershëm, historitë e letërsisë shqipe në mënyrë ngulmuese kanë krijuar një opozicion ideologjik e letrar mes tyre.

Në vitin 1971, kur, gati pas një shekulli, u botua në gjuhën shqipe *libri i fantazive* i Naimit, me titullin në origjinal *Tehajjûlat*, shkruar e shtypur persisht në vitin 1885 (në tipografinë *Mirhan* të Stambollit), në një përshtatje rikrijuese me një elegancë të rrallë nga iranologu e orientalisti Vexhi Buhara, me titullin *Ëndërrime* (shpesh titulli i saj citohet gabim në formën e shquar *Ëndërrimet*), për herë të parë iu rikthye vlerësimi një pohimi të hershëm të Eqrem Çabejt: *Ai nuk është europiani që shkel këtë botë - në Orient - si një i huaj dhe për të cilin kjo ka magjinë e vendit ekzotik. Ai është fis me këtë botë; ai rron në të, është i saj* (Çabej : 1944-1994). Edhe pse të shkruara në një gjuhë tjetër dhe të ardhura në shqip si përkthime, *masnavitë* e vëllimit *Ëndërrime* u vlerësuan nga studiuesit shqiptarë si *bukuroshja e fjetur*.

Aspak për rastësi, studimi i Eqrem Çabejt, për dy degët, dy kryeqendrat dhe dy kahjet e romantizmit shqiptar: e para që vinte nga Lindja, me mitin e Perëndimit dhe me Naim Frashërin në qendër; dhe e dyta që vinte nga Perëndimi, me Jeronim de Radën si shembëlltjërë, me ekzotikën e Lindjes, do të botohej vetëm në vitin 1994.

Edhe në historinë e letërsisë iraniane Naim Frashëri është paraqitur vonë. I pari që përmendi krijimtarinë e tij në persisht ishte studiuesi vendës Abdül-Karim Gölshani, i cili, në vitin 1975, botoi në Shiraz artikullin *Rreth letërsisë perse shkruar në hapësirat turke dhe poezisë perse të autorit shqiptar të shekullit XIX Naim Frashëri - Farhang-i Iran dar qalamraw-i Turkan: ash 'ar-i Farsi-i Na'im Farashari, sha'ir va nivisandah-'i qarn-i nuzdahum Albani* (Gölshani 1975). Deri para dy dekadash *fantazive* të tij persisht, librit më të hershëm të tij, *Tehajjûlat*, në historinë e letërsisë iraniane u është rezervuar vetëm një paragraf, në të cilin paraqitet si *poet bektashi me origjinë shqiptare, që shkroi masnavi, në stilin e Moulana-s* (Golshani : 2004). Pas Musine Kokalarit (1943), në pikëpamjen kronologjike, merita e zbulimit më në thellësi të vendit të Naimit në historinë e letërsisë perse i takon studiuesit Ali Akbar Zijai (1997-1998), që drejtoi për disa vite me radhë Fondacionin Kulturor *Saadi Shirazi* në Tiranë dhe bëri kërkime të drejtpërdrejta jo vetëm për vjershërinë e tij në gjuhën perse, por edhe për intertekstualitetin e shumë

poezive filozofike të poetit kombëtar të shqiptarëve me veprën e Pir-Roumi-ut (Zijai 1997). Në librin monografik “*Vendi i shqiptonjave*”, i njohur në Iran (Zijai 2003), kërkimet u finalizuan me një sintezë krahasimtare, që hapën udhë për ta konsideruar Naim Frashërin si një poet me pjesë e kontribut në dy letërsi e në dy histori letërsie. Këto kërkime u bënë një nxitje tjetër për dijetarët shqiptarë, studiues të letërsisë dhe të gjuhës shqipe, për të gjetur shpjegime të denja dhe të provuara shkencërisht për ndërthurjen e kodeve poetike të vjershërimit lindor e perëndimor në veprën e Naimit, siç kishte paralajmëruar E. Çabej qysh në vitin 1945, si dhe për të shkruar libra monografikë rreth tipologjisë së dyfishtë të lirikës së tij, në të cilën bashkohen e shkrihen lehtësisht e paqësisht misticizmi lindor dhe iluminizmi perëndimor (Bulo 1999). Nga këto studime tashmë është qartësuar mirë e bindshëm se kushtëzimet e poezisë së Naim Frashërit me atë të Roumi-ut janë të shumëfishta: **i**) në modelet e vjershërimit; **ii**) në tipologjinë e llojeve; **iii**) në kodet poetike; **iv**) në botëkuptimin panteist dhe në filozofinë e jetës; **v**) në teozofi e misticizëm, **vi**) në rrafshin tematologjik e në atë të motiveve.

Naim Frashëri, jo vetëm tek *Ëndërrime*, por edhe kur shkruan shqip, sidomos në lirikën filozofike, në lirikën didaktike, në lirikën e natyrës dhe në atë të dashurisë, parapëlqen *masnavinë* dhe shpesh rikrijon sipas gjedhes poetike dhe metrike të Pir-it që ndjek, Moulana-s; ndonjëherë *katrenat* e Khajamit dhe jo rrallë edhe *gazelet* e Hafizit.

## II. Rikthimi i Naimit tjetër

Kemi zgjedhur të përdorim termin *rikthim* për shpalljen e pjesës së heshtur të veprës së Naimit, të *Naimit tjetër*, *Naimit lindor*, më së pari pers, sepse, duke i vënë të dhënat në një kronologji të vërtetueshme, rezulton se dukuria ka qenë e njohur qysh në gjysmën e parë të shekullit XX. Hafiz Ali Korça, poet dhe dijetar i njohur persolog, që, i pakënaqur prej lirive që i kishte dhënë vetes Fan Noli, botoi një përkthim alternativ të *katrenave* të Omar Khajamit, ishte i pari që shkroi edhe për konkordancat në fabul, në motiv e në frymë midis *Fyellit* të Naimit dhe *Nej-name-së* së Rir Roumi-ut. Hafizi njoftoi në atë kohë madje se Naimi kishte shkruar në persisht edhe një poemë tjetër liriko-epike religjioze, veç *Qerbelasë*, me titullin *Vajtimet e Imam Hüssein-it*, që mbetet e pazbuluar deri më sot. Duke perifrastuar titullin e poemës së Naimit, ai vetë shkroi *Vajtimet e atdheut*. Mirëpo studimi i kësaj dukurie më pas u ndalua, për disa arsye: **i**) për shkak të një qëndrimi të vijueshëm kritik ndaj trashëgimit letrar shqiptar me alfabetë orientale (persisht, osmanisht dhe arabisht), njohur si *letërsia e bejtexhinjve*; **ii**) për shkak të *demonizimit historik e kulturor* të ish-perandorisë osmane dhe përgjithësisht të dukurive që mund të kishin lidhje me të; **iii**) për shkak të ateizmit shtetëror që ka ekzistuar në Shqipëri deri në vitin 1990. Kjo ka qenë

arsyeja dhe pse vetëm në tri dekadat e fundme u bë e njohur ekzistenca e *një gramatike të persishtes në dorëshkrim* prej Naim Frashërit dhe e dy dramave të të vëllait, Samiut, shkruar mbështetur mbi motive të *Shah-Name-së* së Firdeusiut, *Gjahve* e *Suhrab*, njëra prej të cilave ende e pabotuar.

Këtyre shkaqeve të përgjithshme u duhet shtuar dhe një arsye e veçantë. Musine Kokalari, që qysh në vitet 1930-1940 bëri kërkimet dhe zbulimet e para për lidhjet e poezisë së Naimit me veprën poetike dhe mendimin e Moulana-s, u dënua si kundërshtar politik qysh në vitin 1946 dhe studimit të saj iu ndalua botimi. Teza e saj, e para kushtuar poezisë së Naimit është ende e pabotuar dhe ruhet në dorëshkrim në Arkivin Qendror Shtetëror dhe në Bibliotekën Kombëtare, përveç arkivit letrar të Universitetit *La Sapienza* të Romës.

Ishte pikërisht Musine Kokalari ajo që, gati një shekull më herët, ndërsa po përmyllte studimet e laureimit për literaturë në Romë, zgjodhi si tezë diplome veprën e Naim Frashërit dhe pati vërejtur me mprehtësi ngjashmërinë e poezisë së Naimit me atë të Pir-Roumi-ut. E njohur me *masnavitë* (*mesnevitë*) e Mjeshtrit të letërsisë klasike perse përmes përkthimit italisht (Pizzi 1894 : 269-278), në tezën e saj të diplomës kushtuar Naim Frashërit mbrojtur në Romë në vitin 1943, ajo do të shkruante: *Çudia ime që e madhe kur konstatova se shumë vargje të Naimit rezultojnë identike me ato të poetit persian Xhelaledin Rumi. Në librin Storia della poesia persiana të Italo Pizzi-t, ajo pati mundësi të lexonte gjithsej 11 poezi të Moulana-s: pesë nga Kobla shpirtërore (La Cobla spirituale) dhe gjashtë nga Këngëtorja (Il Canzoniere). Musine Kokalari i tërhoqën menjëherë vëmendjen vargjet e poezisë së njohur Nej: Dëgjojeni fyellin si flet e vajton - Ascolta flauto che parla e piange (Pizzi 1894 : 269) dhe Tregtari e papagalli, ose më mirë për nevojën e çlirimit të vetvetes nga burgu i jetës - Il mercante e il pappagallo, ovvero della necessità di liberarsi dal carcere della vita (Pizzi 1894: 271-273).*

E lindur në Adana të Turqisë, e ambientuar me qytetërimet dhe kulturat e Orientit, megjithëse nuk e njihnte persishten, megjithëse në shqip libri *Ëndërrime (Tehajjulat)* nuk ishte botuar ende dhe ndoshta as e dinte se mund të ekzistonte, Musine Kokalari i mjaftoi përkthimi italisht i një koleksioni të poezive të zgjedhura të *Pir-it* të letërsisë klasike perse për të arritur në përfundimin se:

1. Dy poezitë e njohura të Naimit, *Fyelli* (nga vëllimi *Lulet e verës*) dhe *Turtullesha* (nga cikli *Parajsa*), janë paralele, në mos përkthime apo rikrijime prej poezisë së Roumi-ut *Nej*, botuar italisht me titullin *La Cobla spirituale*. Poezia e parë është krahasuar me *Pjesën hyrëse të Cobla-s spirituale*. Për të njëjtën poezi Musine Kokalari gjen dhe një referencë tjetër, duke vërejtur ngjashmëri të dukshme me disa prej strofave të poezisë fabuleske *Tregtari dhe papagalli apo nevoja për të çliruar veten nga burgu i jetës*. Poezinë e dytë, *Turtullesha*, M. Kokalari e përfron edhe me një

*masnavi* tjetër të Roumi-ut, titulluar *Tri këshillat e zogut - I tre consigli dell'augellino* (Pizzi 1894 : 273).

2. Duke thelluar krahasimet me letërsinë klasike perse studiuësja laureante Musine Kokalari, megjithëse teoria e intertekstualitetit do të shfaqej gati një gjysmë shekulli më vonë, provon, përmes leximit paralel, se poezia *Ujët e bekuar* e Naimit është një rikrijim prej *katrenës* me të njëjtin titull të Omar Khajamit, një *rubai* (*rubā'iyāt*) kushtuar dehjes shpirtërore me mendimin e thellë. Ashtu si në *katrenën* e Khajamit, poezia e Naimit është shkruar me strofa katërvargëshe, me rimë AAAB: *Shkel-e-shko zëmëra ime / Mos bjerë në hidhërimë / E në breng'e në mejtime / Mos të gënjenjë kjo jetë* (*Ujët e bekuarë*, vv. 45-48).

Në librin *La mia vita universitaria*, kujtime dhe ditar ruajtur në arkivat italiane dhe botuar para dy vjetësh në Romë nga Simonette Ceglie dhe Mauro Geraci, ka shumë të dhëna për njohjet vetjake të Musine Kokalarit me përfaqësues të breznisë së fundme të Rilindjes shqiptare, që vazhdonte të vepronte në gjurmët e Frashërlinjve në kryeqendrën e ish-perandorisë osmane tashmë në rrënim. *Unë jam nxënësja e Sami Frashërit*, shkruan ajo në ditar. Botimi shqip e në gjuhën iraniane e librit të saj për Naim Frashërin dhe lidhjet e tij poetike, estetike, botëkuptimore, mistike dhe filozofike me Moulana-n, që mund të realizohet me kujdesin dhe dashamirësinë e Fondacionit Kulturor *Saadi Shirazi* dhe të drejtorit të tij prof. Hussein Alast, do të pasuronte bibliotekat tona me veprën më të hershme kushtuar kësaj problematike. Më tej, studimet do të thelloheshin duke u vënë në kërkim të pranive të tjera të letërsisë klasike perse në traditën letrare shqiptare, sidomos të Roumi-ut dhe të Khajamit në prozën dhe poezinë e Dritëro Agollit (Sinani 2007 : 117-126).

### III. Naimi, Moulana dhe poetë të tjerë lirikë persë

Në tri dekadat e fundme, pas zhbërjes si disa kufijve të rreptë ndalues ideologjikë dhe fetarë, pikëtakimet midis poezisë së Naimit dhe letërsisë së Roumi-ut studiuësit i kanë shtuar, duke gjetur paralele të qarta mes dy poetëve jo vetëm në rrafshin tematologjik, jo vetëm në shkallën e tekstit, por edhe në prozodi, në tipologjinë e lirikës, në modelet e vjershërimit, në kodin poetik, në frymëzimin mistik dhe në botëkuptimin filozofik (Zijaj : 1998; Buló : 1999). Tashmë, përmes metodës së tekstologjisë kritike, mendimi hipotetik i Musine Kokalarit se poezia *Nej* e Roumi-ut dhe vjersha *Fyelli* e Naimit janë prej një burimi të përbashkët; po ashtu sikurse dhe vjersha *Zogu dhe djali* dhe *Tri këshillat e zogut - I tre consigli di augellino*, janë të provuara me mjete mirëfilli letrare (Bulo 1999). Njohja e lidhjeve tekstore të poezisë së Naimit *Fyelli* me *Nejnamenë* e Roumi-ut nxiti dhe studime mirëfilli iranologjike rreth historisë së *masnavive* (Hamiti-Agagjyshi 2014: 61-81).

Në frymë e në frymëzim, poezia e Naimit, ashtu si ajo e Roumi-ut, përshkohet nga *fana* (pers. فنا, *vdekje*), një kategori mendimi që në filozofinë dhe letërsinë klasike iraniane shenjonte sublimimin e vetëflijimit (nga gr. *evlogia*, *εὐλογία*, *bekim*), shenjtërimin e *tretjes filozofike në emër të lartësimit shpirtëror* (Zijai 1998: 69-77) apo të *mirësisë fisnikëruese* (Ressuli 1955), për t'u shkëputur prej tokësore së përkohshme përmes këndelljes prej idesë së afrimit tek Krijuesi (Pagliano-Bausani : 1968; Zijai : 1999). Në vështrimin e sotëm perëndimor, kjo mënyrë e të kuptuarit të botës përkufizohet herë si *mesianizëm*, herë *prometeizëm*, dhe si dukuri është identifikuar edhe tek eposi religjioz *Qerbelaja* (Guidetti 2015 : 83-104).


Përthyerjen e natyrshme të misticizmit klasik persian me iluminizmin evropian në poezinë e Naim Frashërit, që shfaqet nëpërmjet vetëflijimit për t'iu afruar hyjnore nga njëra anë dhe për të ndriçuar përparimin e njerëzisë nga ana tjetër, ashtu si Danko në tregimin *Plaka Izegril* (*Смапыха Изегриль*) të Maksim Gorkit, studiuesit e gjejnë edhe prej krahasimit të *Fjalëve të qiririt me gazelet* e Hafizit (Hafizi : 2004). Këto dy dukuri vështirësisht të përafrueshme: e para, me karakter sublimues të ndjenjave të besimit dhe e dyta kritike ndaj ideve të shenjta, tek Naimi u bashkuan në një mënyrë shumë origjinale. Ashtu si *nej* i ngjan njeriut, ashtu *qiri* është metonimia e shpirtit të poetit, që, në një anë shpreh misionin e ndriçimit të progresit të shoqërisë njerëzore, ashtu siç ishte në filozofinë e *le siècle de lumiere*; kurse në anën tjetër shpreh të kuptuarit e jetës si një dhunti hyjnore që duhet të ketë si qëllim lartësimin drejt dritës së përvetshme.

Thellimi në lexim të krahasuar ka bërë të njohur se edhe shumë nga vjershat didaktike me karakter fabule të Naimit, si *Pesha*, *Korbi dhe dhelpra*, *Gomari dhe kafshët e egra*, *Dragoj plak dhe dhelpra*, *Pëllumbat dhe laraska*, *Gomari i egër dhe i buti* dhe *Guguçeja*, në pikëpamje të tekstit dhe të rrëfimit, po aq dhe të kumteve morale dhe edukative, janë rikrijime ose së paku me zanafillë nga *masnavitë* e Moulana-s (Bulo 1998; Rexhepi 2015).

Një prej prurjeve të reja të studimeve krahasuese për poezinë e Naimit dhe letërsinë klasike perse ka lidhje me *teozofinë*, me kuptimin e vetes dhe botës, me unicitetin e Krijuesit dhe me shkrirjen e fytyrës së Zotit në gjithçka që ekziston. Në një mënyrë a një tjetër në këto raste kemi të bëjmë me pamjet laike që marrin shembëlltyrat dhe urtësitë e *Kur'an-it* në art e letërsi. Vjersha *Perëndija* është krahasuar me një *masnavi* të Roumi-ut (Shehabi : 2014). Nuk është një dukuri përjashtuese që poezitë e Roumi-ut të nisin në një mënyrë të tillë, *bez bismille i temhidom*, pa *bis'mil'alh e përfalje*, pa *Ves-selam e lartësim të Hyjit*, pa lejen urdhëruese nga *Ai që është lart* (Çamdžić 2015), duke përfshirë dhe *Nejname-në*. Dhe vërtet, poezia *Perëndija* e Naimit ndjek në *fjalë e në frymë* *masnavinë* e Mjeshtrit *Burri dhe thesari*. Por, duke e parë çështjen më në thellësi, pavarësisht mungesës së përthirrjes së lutjes

kanonike, mund të provohet se të dyja bashkë janë frymëzime të drejtpërdrejta prej një burimi të përbashkët, prej Shkrimit të Shenjtë (*Kur'an* : 17-79).

Studiuesit e sotëm janë të prirur se e gjithë historia e letërsisë botërore është me karakter rikrijues dhe se kodi i kodeve të saj janë pikërisht *Shkrimet* (Frye 1982). Roumi-u i parapriu mendimit njerëzor me idenë e fisnikërimit të qenies duke shenjtëruar botën, duke shpallur *Shën Tokën*. Naimi, me panteizmin e tij bektashian, e rishpalli atë në dritë të parimeve të romantizmit, në mënyrë të veçantë në pajtim me kultin e natyrës.



*Naim Frashëri, Albanian muslim, persian speaking poet: Naim Frashëri, mysliman shqiptar, poet që shkroi persisht. Portret i Naimit në filateli, zarfe e kartolina iraniane (1997).*

Poema *Bagëti e Bujqësia* e Naimit, që për shumë kohë disi me druajtje është krahasuar me *Bukoliket e gjeorgjiket* e Virgjilit dhe me *Punët e ditët* e Hesiodit, në kohën e sotme shihet shumë e afërt me surenë *Arka e Nuhut* në *Kur'an* (*Arka e Noes* në *Bibël*), si dhe me *Kabala*-në hebreje, në të cilën mendimtarët udhëzohen: *Vend i mirë për të medituar është një livadh jashtë qytetit*. Poezia e Naimit *Një lule e vyshkur apo një vajzë e vdekur*, njësoj si dhe vjershat *Zemra, Fyelli, Perëndija* e *Bilbili*, janë të përshkuara prej ideve themelore të teozofisë klasike perse, sipas së cilës *zemra është selia e Zotit* dhe shpirti njerëzor shndërrohet në dritë. Pikërisht kjo metamorfozë shenjtëron dritën, por të kuptuar krejt ndryshe prej leximeve tradicionale të kësaj shenje aq të pranishme në poezinë e Naimit, i cili shqiptohet me të njëjtat parime

filozofike: *Zemër e njeriut në jetë / Është vend i Perëndisë / Është atje Zot i vërtetë / Zot i math i gjithësisë*. Ky përfytyrim i Naimit është i njëjti si në *Kur'an*, ku zemra konsiderohet një *stacion panegjirizmi* dhe *megalizie* të Krijuesit (*Kur'an* 17 : 19). Drita, zemra dhe Krijuesi përbëjnë një trini edhe në masnavitë e Moulana-s, edhe në poezitë e Naimit.

Ndërtekstorësia që bashkon poezinë e Naimit me atë të Roumi-ut dhe herë-herë edhe me atë të Hafizit dhe të Khajamit ka lidhje jo vetëm me prejardhjen e tij, me formimin shpirtëror që mori në fëmijëri si nxënës i teqeve të Frashërit dhe sigjyshërve bejtexhinj; jo vetëm me autoritetin botëror që kishte poezia klasike perse, për të cilën në shekujt e humanizmit thuhej se ishte rikthyesja e parë e vëmendjes tek lashtësia antike e qytetërimeve greke dhe romake; jo vetëm në statusin e persishtes në vetë ish-perandorinë otomane si *lingua franca* krahasuar me gjuhën zyrtare të saj, e cila kishte shkallën e një gjuhe popullore; por edhe me fatin personal të tij si njeri e si shkrimtar; me shijet estetike dhe me gjedhet e të menduarit.

Të gjitha këto fije të padukshme, gjithnjë e më të shkodifikuara, që ndërldhin poezinë e Naimit me atë të Pir-Roumi-ut, na çojnë deri tek pyetja: Nëse ideologjikisht, për shkak të urgjencës që kishte Shqipëria për t'u ndarë nga një perandori sunduese mbi trojet e saj, nga një perandori që i takonte Lindjes, në poezinë e tij *Për se*, shkruante si një iluminist: *Jak'o dit'e uruar / Që lind nga perëndon*; në botëkuptimin dhe filozofinë e tij për veten dhe botën, për njeriun dhe Krijuesin, pra, në bindjet e tij vetjake, ishte më pranë kuptimit lindor mistik e teozofik? Naim Frashëri, pavarësisht nga u orientua, në përputhje me misionin si poet kombformues, ndoqi modelin dhe ruajti identitetin e tij, që i diktohej nga origjina (Gylsheni 2000 : 11). Me sa duket, kjo do të jetë një nga pyetjet më të ndërlikuara të së ardhmes para studiuesve për veprën e tij. Eqrem Çabej kishte plotësisht të drejtë kur shkruante për Naimin se *ai është fis me këtë botë; ai rron në të, është i saj*. Mendimtari reformator suedez i shekullit XVIII Emmanuel Swedenborg, në kërkim të mundësive të reja të përtëritjes morale të Krishterimit, me shpresë në *ardhjen e dytë të Mesisë*, në traktatin e tij *The Heavenly Doctrine*, shprehej: *Engjëjt e kanë të kthyer vështrimin drejt Orientit*.

Fan S. Noli, kryepeshkop e kryeministër, poet e përkthyes në shqip i rubaive të Omar Khajamit, i krahasuar botërisht për nga fuqia shprehëse vetëm me përkthimin e Fitzgerald-it, duke provuar të shkruante një himn për Shqipërinë, pohonte në vargje mobilizuese se kryeshenja e saj, flamuri, ishte: *Flamur që lint Shën Kostandinin / Pajton Islamn' e Krishtërimin / Çpall midis feve vllazërimit / Flamur bujar për Njerëzi*. Naim Frashëri, ndonëse adhuronte Roumi-un dhe Hafizin, shkroi poezinë *Përpara Krishtitë* dhe përktheu një prej shembëlltyrave më të njohura të *Ungjillit sipas Shën Gjonit*, me një bukuri të rrallë shqipthënëse. Naimi, ashtu siç bënte njësh misticizmin me iluminizmin, për

qëllime didaktike dhe për lartësim të shpirtit njerëzor, ashtu lirisht alternonte në krijimtari *letërsinë katekistike* të krishterë me *tasavvuf-in* mistik:

Zotit Krisht, një mëngjes, tek mësonte njerëzinë në hijetoret të kënduarit e judeve, që quheshin “shkronjës” dhe “farisenj”, i prunë një grua që kishinë zënë mbë turp, edhe i thonë që në nomtë Moisiu porositi të tillatë të vritenë me gurë, ti, pra, si thua? Këtë ja thoshinë duke ngarë, që të gjeninë punë ta shaninë. Zoti Krisht hodhi sytë poshtë dhe shkruante me gisht mbi dhe. Si vunë këmbë dhe po e pyetninë, ngriti dytë mbë ta dhe tha: “I pafajmi prej jush të hedhë përpara gurë mbi të”. Ata, si dëgjuanë këto fjalë edhe mendja i rrihte, zunë një nga një, nga të mëdhenjtë e gjer tek të fundit, e po dilninë, dhe mbeti vetëmë Zoti Krisht dhe gruaja që po qëndronte ndë mest. Si ngriti sytë Zoti Krisht përsëri dhe s’pa njeri veç gruanë, i tha asaj: “Grua, ku janë ata që të hiqninë fajtoje? Asnjë s’të dënoi?” Dh’ajo u përgjegj: “Asnjë, o Zot”. Pra, i tha Zoti Krisht, as unë s’të dënonj, shko tashi dhe mos bënëj faj më (John 8 : 1-11)<sup>2</sup>.

**Shembëlltyra e Mari Magdalenës nga Ungjilli sipas Gjonit (nga Bibla)**

**Shembëlltyra e provës së engjëjve me dy djemtë e Imam Aliut (nga Kur’an-i)**



ZOTI KRISHT



ZOTI ALI EBE FEMIJA E TI

Zoti Krist në mëngës mlek mesonte zëne në hijetoret, të kënduarit e Iudaje

E sou’ e Aliut Fatimeja kis mape pake mlek hua. kis mbrujture në kulag, q’ e kis stene në punet; të dy djemt’ e tyre Hasani dhe Hysejmi

\* Khs. përkthimin e Konstantin Kristoforidhit, Ungjilli sipas Gjonit, 8 : 1-11 (1879): *Edhe Jisuj vate ndë malt t’ullinjvet. Edhe mbë të-vagulluarët erdhi përsëri ndë hieroret, edhe gjithë llauzi vinte tek ay; edhe ay ndënji e i mësonte. Edhe shkronjësit’ e farisenjtë i bjenë një grua të-zënë ndë kurvëri, edhe si e vunë ndë mest, i thonë: Mësonjës, këjo grua është zënë mbi punët dyke kurvëruarë. Edhe Moisiu ndë nomt na ka porositurë të-tellatë gra të vritenë me gurë; ti pra ç’thua? Edhe këtë e thoshinë dyke ngarë atë, që të me se t’a përflasënë. Po Jisuj uunjt, e skruante me gishinë mbë dhet. Edhe passi qëndroninë dyke pyetur’ atë, ungrit, e u tha atyre: I pafajmi prej jush, ky më përpara le të hedhë gurinë mbi atë. Edhe përsëri u unjt, e shkruante mbe dhet. Edhe ata kur dëgjuanë, edhe pasi qërtonëshinë prej ndërgegjesë, zunë të dilninë jashtë një nga një, që prej pleqvet e gjer mbë të-fundëshmit; edhe Jisuj mbeti vetëmë, edhe gruaja ishte dyke ndënjurë ndë mest. Edhe Jisuj si ungrit, edhe nukë pa asdonjë veç gruasë, i tha asaj, Grua, ku janë ata që të përflisninë? Asndonjë s’të dënoj? Edhe ajo tha: Asndonjë, Zot. Edhe Jisuj i tha: As unë nukë të dënonj; shko, edhe mos fëje më.*

qallrsine ekróqes ñe Farisíq, i príme ñe  
 qe kísine zene mbe turp, eñé i ñone, i  
 noum Moisiu pouosí te títate te vriten  
 gúre; ti pra si ñua? keté ja ñosine duke  
 qe te pénine pure tà sáaine, Zoti Krist  
 sýte póste ñe ekrúante me gíst mbe ñ  
 vime kembe ñe po e pyéfine, ugrití: sýte  
 tà ñe ña, i pafájmi práj jus te hée ñe  
 gúr mbi té; eñé perseri. ñodi sýte post  
 ekrúante mbe ñé; atá, si depóune keté ñal  
 menlja i pihite, zane qe ngu qe qe ngu i  
 ñrúte e per te te fundit e po ñeline eñé  
 vétene Zoti Krist, ñe grúaja qe po qend  
 nle mest; si ugrití: sýte Zoti Krist perser  
 s' pa ñeri vë ñaune, ñe asáj, gnaa, ká jan  
 qe te kúine fajtoe, asqé s' te denój? ñ' ajó  
 gëq, Asqé, o Zoti, pa i ña Zoti Krist, A  
 s' te denój; eko taci ñe mos ben faj mé.

prísine t' úret' e te qete. Me te pñekure, e  
 nxori kulagne Fatimeja ñ' e kroj, si aftòh  
 pake, e beri dy cope e uà ña djemet.

Ëlloa i miápe Hasani me Hysejme nder duar,  
 dy djem te vúrfer' ađane me dere e kerkdane  
 buke, Hasani ñe Hysejni ungru' eñé uà ñane  
 pa mape as kafeite, eñé ndenne mape t' ñete.

Fatimeja umakengye, púdi se pari te vúrfe-  
 rite e i nrój, pasdáj eñé djem' e saj.

Aliu u ña: Zoti i vertete u dergój eñgeñite,  
 qe t'u sili zémereue t'aj. Lum ay, qe zé-  
 meren' e ña te qerqar, e ka qerezine ne zé-  
 mere. Lum ay, qe pi i úrete vete per te ngi-  
 ñare te vúrferine; atá qe pate me dere i kúni  
 vëlezere. Beni kundohre mire, e mos beni kúpe  
 likete, se qeriu vlen vage, sa i vlen puma, qe  
 ben. M' i mir i lisit este vatij' e mire; m' i  
 mir i qerezise est' ay, q' i ben mire qerezise.  
 M' esija este Zoti, ligesija este djañi.

Naim Frashëri, *E këndimit të çunave këndonjëtoreja* (Bukuresht 1886, f. 18-20)

## BIBLIOGRAFI

- Gölshani, A. K., *Farhang-i Iran dar qalamraw-i Turkan: ash'ar-i Farsi-i Na'im Farashari, sha'ir va nivisandah-i qarn-i nuzdahum Albani - Rreth letërsisë perse shkruar në hapësirat turke dhe poezisë perse të autorit shqiptar të shekullit XIX Naim Frashëri*, Shiraz, 1975.
- Gylshani, A., *Naim Frashëri - poeti shqiptar që shkruan në gjuhën persiane: në 100-vjetorin e vdekjes së Naim Frashërit*, në "Flaka", Shkup, 29 maj 2000.
- Golshani, A. K., *Kultura iraniane në territoret e pushtuara nga Turqia - poezitë në gjuhën persiane të Naim Frashërit, poet dhe shkrimtar shqiptar i shekullit XIX, përkthim shqip, ruhet në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë*.
- Golshani, A. K., *History of persian literature*, Tehran, 2004.
- Pagliano, A., Bausani, A., *La letteratura persiane*, Firenze, 1968.
- Rexhepi, A., *Naim Frashëri dhe kodi letrar persian: Gjurmë të Mevlana Rumiut në poezinë e Naim Frashërit*, në aktet e Seminarit XXXIII

- Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, nr. 33/2, Prishtinë, 2015.
- Hamiti, A. dhe Agagjyshi, U., *Interpretimi i këngës "Neji" të Mevlana Xhelaluddin Rumi-ut*, në revistën "Hikmet", nr. 5, Prishtinë, 2014.
- Tamimdari, A., *Historia e letërsisë perse*, Tiranë, 2011.
- Zijai, A. A., *Studim krahasues i mendimeve të Naim Frashërit dhe filozofëve të Lindjes të "Takhajolat"*, në "Perla", nr. 2, 1996.
- Zijai, A. A., "Dhimbja e fyellit" e Xhelaludin Rumiut, në revistën "Perla", nr. 4, Tiranë, 1997.
- Zijai, A. A., *Gjuha e zemrës ose njohja e universit (një vështrim i shpejtë mbi librin "Ëndërrime" të N. Frashërit)*, në "Perla", nr. 4, Tiranë, 1998.
- Zijai, A. A., *Të kuptuarit e tretjes dhe njohjes të Naim Frashërit*, në revistën "Perla", nr. 1-2, Tiranë, 1998.
- Zijai, A. A., "Vendi i shqiptarëve", i njohur në Iran, Tehran 2003.
- Leka, A. (ed. alt.), *Naimit*, bot. "Naim Frashëri", Tiranë, 2000.
- Agolli, D., *Punove mirë, usta*, në *Arti dhe koha*, bot. "Naim Frashëri", Tiranë, 1980.
- Swedenborg, E., *Heaven and its wonders and Hell from things heard and seen*, USA, 2001.
- Çabej, E., *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*, bot. "MÇM", Tiranë, 1994.
- Fishta, (Àt) Gj., *Lahuta e Malcës*, bot. "Shtypshkroja Franceskane", Shkodër, 1937.
- Pizzi, I., *Storia della poesia persiana*, volume I, Roma, 1894.
- Bulo, J., *Magjia dhe magjistarët e fjalës*, Tiranë, 1998.
- Bulo, J., *Tipologjia e lirikës së Naim Frashërit*, bot. i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 1999.
- Bulo, J., *Ëndërrimet poetike të Naim Frashërit*, në "Ëndërrime (Tehajjulat)", Tiranë, 2005.
- Maloki, K., *Oriental apo Okcidental*, në "Hylli i Dritës", nr. 1, Shkodër 1937.
- Geraci, M., *Prometeo in Albania: passaggi letterari e politici di un paese balcanico*, Roma, 2014.
- Shehabi-Veseli, M., *Marrëdhëniet intertekstuale sipas Zherar Zhenetit në poezitë e Naim Frashërit*, në "ANAS", nr. 5-6, Shkup, 2014.
- Rumi, M. Xh., *Mas'navi Manavi*, përktheu Dhori Qiriaz, Tiranë, 2007.
- Isaku, M., *Zjarri prometeik në poezinë e Naimit*, në "Jehona", nr. 1, Shkup, 1991.
- Kokalari, M., *Naim Frashëri (1846-1900)*, dorëshkrim, tesi di laurea in letteratura albanese (anno accademico 1940-1941), ruhet në Bibliotekën Kombëtare, Tiranë.

- Kokalari, M., *La mia vita universitaria: memorie di una scrittrice albanese nella Roma fascista (1937-1941)*, a cura di Simonette Ceglie Mauro Geraci e, ediz. "Viella", Roma, 2016.
- Frashëri, N., *Vepra*, I-VI, bot. "Toena", Tiranë, 2007.
- Ressuli, N., *Naim Frashëri - poet i mirësisë*, në "Shpirti shqiptar", nr. 1-2, Torino, 1955.
- Čamdžić, N., *Živa baština*, na *Časopis za filozofiju i gnozu*, br. 1, izdat. "Baština duhovnosti", Mostar decembar 2015.
- Frye, N., *The Great Code: The Bible and Literature*, edit. Penguin Books, 1982.
- Qosja, R., *Prometeizmi në poezinë shqipe*, në librin "Kontinuitete", bot. "Rilindja", Prishtinë, 1972.
- Qosja, R., *Panteoni i rralluar*, bot. "Naim Frashëri", Tiranë, 1988.
- Karami, R., *Roli i vëllezërve Frashëri në përhapjen e gjuhës dhe kulturës perse*, në "Perla", nr. 4, Tiranë, 2006.
- Karami, R., *"Masnavitë" - odet e Lindjes*, në "Perla", nr. 3, Tiranë, 2007.
- Sinani, Sh., *Dorëshkrime të veprave të Saadiut në Shqipëri*, në "Perla", nr. 1, Tiranë, 2007.
- Sinani, Sh., *Motive paralele në eposin e kreshnikëve dhe në "Shah-Name"*, në "Perla", nr. 3, Tiranë, 2005.
- Sinani, Sh., *Si mbërriti "Divani" i Hafiz Shirazit në botën shqiptare*, në "Perla", nr. 1, Tiranë, 2006.
- Sinani, Sh., *Personaliteti i Rumiut në romanin "Arka e djallit" të Dritëro Agollit*, në "Perla", nr. 4, Tiranë, 2007.
- Sinani, Sh., *Prurje kulturore orientale*, bot. Albas, Tiranë, 2007.
- Sinani, Sh., *Berat, Beratinus, Buhara*, bot. Naimi, Tiranë, 2015.
- Guidetti, V. L., *Angeli piangenti al cospetto di Dio*, në "Studia Albanica", nr. 1, Tiranë, 2015.

## SUMMARY

### NAIM AND ROUMI IN THE CONTEXT OF THE PERSIAN CULTURE PRESENCE ON THE ALBANIAN TRADITION

These researches became encouragement for the Albanian savants, scholars of Albanian literature and language, to find worthy explanations and scientifically proved on the intertwining of the poetic codes of Eastern and Western versification in Naim's work, in which are peacefully and easily melted the Eastern mysticism with the Western enlightenment. From these studies has already been decently and convincingly clarified that

the conditioning of Naim Frashëri's poems with that of Rumi are manifold: **i)** on the versification models; **ii)** on the types of typology; **iii)** on poetic codes; **iv)** on the pantheist world-outlook and in the life's philosophy; **v)** on theosophy and mysticism, **vi)** on thematic plane and on the motives one. Musine Kokalari, that since 1940-1943 made the first research and discoveries about the connection of Naim's poetry with the Moulana poetic work and thinking, was condemned as political opponent since 1946 and her study was forbidden to be published. Her theses, the first dedicated to Naim's poetry is still unpublished and is preserved as manuscript at the National State Archive and in the National Library, besides the literary archive of "*La Sapienza*" University of Rome. Was exactly Musine Kokalari who a century earlier, while was concluding the graduate studies for literature in Rome, chooses the work of Naim Frashëri, and observed with sharpness the similarity between Naim's poetry with that of Pir-Roumi. Expert of "*masnavi*" of the master of the Persian classical literature through the Italian translation, in her diploma theses dedicated to Naim Frashëri, when she graduated in Rome on 1943, she would write: "My greatest surprise was when I noticed that many verses of Naim result identical with those of the Persian poet Jalaluddin Roumi. In the book "*Storia della poesia persiana*" of Italo Pizzi, she had the possibility to read overall 11 poems of Moulana: five from "*Spiritual Cobla*" ("*La Cobla spirituale*") and six from the "*Singing*" ("*Il Canzoniere*"). To Musine Kokalari immediately attracted her attention the known poem "*Nej*": "*Ascolta flauto che parla e piange*" and - "*Il mercante e il pappagallo, ovvero della necessità di liberarsi dal carcere della vita*". For Musine Kokalari was enough the Italian translation of a selection poems collection of *Pir Moulana* from the classic Persian literature to come to the conclusion that: **1.** The two known Naim poems, "*Fyelli*" (from the volume "*Lulet e verës*") and "*Turtullesha*" (from the "*Paradise*" cycle), are parallels, if not re-creations from Roumi's poem "*Nej*", published in Italian under the title "*La Cobla spirituale*". The first poem has been compared with the introducing part of "*La Cobla spirituale*". On the same poem, Musine Kokalari finds another reference, observing similarities with some of the verses from the fable "*Tregtari dhe papagalli apo nevoja për të çliuar veten nga burgu i jetës*" ("*The merchant and the parrot or the need to free oneself from the prison of life*"). On the second poem, "*Turtullesha*", M. Kokalari approaches it with another Roumi's *masnavi*, entitled "*Tri këshillat e zogut*" ("*The bird's three advices*") - "*I tre consigli dell'augellino*". **2.** Deepening the comparisons with the Persian classical literature, the graduated scholar Musine Kokalari, nonetheless the inter-text theory would show nearly half a century later, proves through the parallel reading that the poem "*Ujë e bekuar*" ("*The holy water*") of Naim is a re-creation from "*katrena*" by the same title of Omar Khayyam, a *Ruba'iyat* dedicated to the spiritual

inebriation with deep thought. As on the Khayyam “*katrena*”, Naim’s poetry is written on quadrisyllabic verses, with AAAB rime: “*Shkel-e-shko zëmëra ime / Mos bjerë në hidhërime / E në breng’e në mejtime / Mos të gënjenjë kjo jetë*” (“*Ujët e bekuarë*”). On the book “*La mia vita universitaria*”, memories and diary preserved in the Italian archives and published two years ago in Rome, has many data about the personal recognition of Musine Kokalari with representatives of the latest generation of the Albanian Renaissance. “*I am a pupil of Sami Frashëri*”, she writes in her diary.